



20.	Sektori Ushqimit	Kuzhinier / Gjellëbërës	4	4.86	I 21
21.	Sektori Ushqimit	Ndihmës gjellëbërës	4	4.76	I 23
22.	Sektori Ushqimit	Mishtarë	1	4.81	I 21
23.	Sektori Ushqimit	Servuese	10	4.76	I 23
		Gjithsej:	68		

1. Titulli i punës: **Inkasant në QKUK)**
Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës: Zyrtarit për të hyra vetanake
Sektori : Buxhet dhe Financa
Kohëzgjatja: Kontrata me afat të pa caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën pranimin e bllokove të participimit nga Arkëtari Kryesor;
- Mban evidencë për bllokat e participimit;
- Bën regjistrimin e arkës ditore sipas specifikacioneve;
- Bën dorëzimin e participimit ditor te Arkëtari Kryesor;
- Bën evidentimin dhe le shuarjen e faturave për pacientet e siguruar;
- Siguron ndarjen dhe ruajtjen e kopjeve përkatëse nga blloku i participimit;
- Siguron kryerjen e participimit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diplomë e Shkollës së Mesme (drejtimi jo mjekësor),
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhe në udhëzime dhe përcjellë informatat të te tjerët,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente);
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel)
- Letërnjoftimi fotokopje.

2. Titulli i punës: **Zyrtar/e Administrativ në QKUK)**
Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës: Shefit të Administratës
Kohëzgjatja: Kontrata me afat të pa caktuar

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

- Mbështetë stafin menaxhues në përmbushjen e aktiviteteve duke bërë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të krijuar raporte përmbledhëse në bazë të indikatorëve specifike.

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Dizajnon format dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave në fushat specifike (klinikat, repartet).
- Mbledh informacionin nga një sërë burimesh të brendshme dhe të jashtme, duke siguruar saktësinë dhe vëmendje në detaje.
- Asiston dhe mbikëqyrë mënyrën e mbledhjes së të dhënave për të siguruar që informacionet e kërkuara janë aty.
- Aftësi për të identifikuar trendët duke analizuar të dhënave dhe raportuar tek përgjegjësi ,
- Propozon rekomandime për ndryshime të proceduarve të cilat rezultojnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitet në fushat përkatëse (klinikat, reparte),
- Raporton dhe krijon raporte organizative në një numër formatesh, duke përfshirë raporte me paraqitje vizuale,
- Sigurimi i informacionit të saktë brenda afatit të përcaktuar,
- Si dhe detyra të tjera të kërkuara nga përgjegjësi.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë e fakultetit - **baçelor:** Juridik, Ekonomi apo Administratë Publike;
- Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndër personale;
- Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Të ketë aftësi për punë në situata të reja dhe të ketë shkathtësi në zgjidhjen e problemeve.
- Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente);
- Letërnjoftimi - fotokopje

3. Titulli i punës:

Recepçionit në QKUK)

Orari i punës:

40 orë në javë (orar të plotë)

Nëpunësi mbikëqyrës:

Shefit të Administratës

Kohëzgjatja:

Kontrata me afat të pa caktuar

Qëllimi kryesor i vendit të punës

- Regjistron të dhënat e pacientëve në databazë.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bën verifikimin nëse pacienti ka qenë tashmë i regjistruar dhe ka një kod personal - nëse nuk ka, i merr të dhënat personale të pacientit dhe bën regjistrimin.
- Planifikon takime –merret me caktimin e termineve edhe konfirmimin e tyre.

- Lajmëron pacientët dhe doktorët për çdo ndryshim në orarin e terminëve.
- Sigurohet që çdo pacientë të jetë i pajisur me raport mjekësor të nënshkruar dhe vulosur nga mjeku pasi kanë bërë dhe pagesën.
- Ruan me konfidencialitet të gjitha informatat personale të pacientëve.
- Mbanë shënime për punën që bënë, si dhe çdo kërkesë dhe ankesë të pacientëve e përcjell deri tek personat kompetent.
- Mirëmbani hapësirën e vendit të punës, përgatit listën e materialeve shpenzuese që kërkojnë për recepsion.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë pranimi dhe dorëzimit të pacientit dhe nëse pala apo pacienti kërkon shpjegime të jep informata të sakta.
- Hartimi i raporteve javore, mujore, vjetore për punën e tij/saj dhe dorëzimi tek Koordinatorja, e cila më pas përgatit dhe raporton e përgjithshëm te Shefi

Njohuria, shkathtësitë, dhe përvoja e kërkuar:

- Shkolla e mesme: jo mjekësore.
- Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndër personale;
- Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
- Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente);
- Letërnjoftimi - fotokopje

4. Titulli i punës:	Arkivist Klinike në QKUK)
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i punës: Arkivist ne Klinika

Qëllimi kryesor i vendit të punës

- Pranon lëndet në arkive, i rregullon ato, i sistemon, i perpunon dhe i arkivon në vendin e caktuar.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Të bëjë pranimin e lëndeve.
- I siguron lëndet arkivore sipas kërkesave, qofte udheqjes së Institucionit ku punon apo edhe paleve që kërkohen fletëshime duplikat.
- Bën pranimin e historive prej reparteve, i kontrollon dhe pastaj i nënshkruan.
- Të gjitha historitë renditen sipas numrit rendor dhe vendosen në regjistrator.
- Bën pranimin e kërkesave nga palët për fletëparaqitje duplikat, shqyrtohen ato kërkesa, gjenden prej historive, fotokopjohen, vërtetohen, nënshkruhen, ju japim palëve sipas kërkesës dhe historitë vendosen në vendet e veta.

- Ju gjejnë dhe ju japin historitë e të sëmurëve dhe protokollet mjekësore në reparte për punime të ndryshme dhe pastaj kthehen në vendet e veta.
- Mban evidence për hyrje dhe daljet e lëndëve arkivore nga arkivi.
- Në afat i mbledhë të gjitha lëndët që duhet arkivuar, i përpunon, i sistemon dhe i arkivon në vendet e duhura.
- Përpilon, shkruan raporte nga puna-veprimtaria e tij dhe i dorëzon Menaxherit të grupit klinik.
- Udhëheq librat e parapara për punë në arkave dhe lëndët arkivore.

Njohuria, shkathtësitë, aftësitë, kualifikimi dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë e Shkollës së Mesme (drejtimi jo mjekësor),
- Të përmbush të gjitha detyrat tjera që kërkojnë nga mbikëqyrësi.
- Të njoh punën me kompjuter (e nevojshme).
- Aftësi për të punuar pa mbikëqyrje
- Të ketë aftësi komunikuese
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Letërnjoftimin fotokopje.

Kualifikimi:

- Shkolla e mesme: Ekonomike, Gjinnaz, Teknik Administrativ, Teknike

5. Titulli i punës:	Inxhinier Biomjekësor në Sektorin e Pajisjeve Biomjekësore në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të paktuar

Përshkrimi i detyrave të punës për profilet profesionale në kuadër të SMPM-së

Inxhinier Biomjekësor

Qëllimi kryesor i vendit të punës

Të mirëmbajë dhe servisoj pajisjet mjekësore, të eliminoj defektet e natyrës hardverike / softverike, të bashkëpunoj dhe përkrahë personelin tjetër përgjatë procesit të ekzaminimit të defekteve në pajisjet mjekësore, zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe t'u ndihmoj në ngritjen e të kuptuarit të funksionalitetit të pajisjeve apo pjesëve vitale të caktuara të tyre si nga aspekti hardverik, po ashtu edhe softuerik. Përkrahja e personelit të sektorit dhe pjesëmarrja direkte në hartimin e specifikacionit teknik për furnizim me pajisje mjekësore, pjesë rezervë, instrumente kirurgjike, material shpenzues, material tjetër medicinal dhe inventar medicinal.

Përgjegjësitë kryesore

- Të aplikoj masat mbrojtëse në punë, ruajtjes së ambientit, respektimit të kriterëve të kërkuara për qasje në hapësira të caktuara gjatë intervenimit në mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Parandalimi i pasojave të padëshirueshme përgjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore si goditja elektrike, rrezatimi jonizues, rrezatimi jojonizues, lëndimet e tj.

- Të ndihmoj personelin e sektorit në planifikimin dhe realizimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore, përgjatë intervenimeve dhe evitimit të defekteve të çastit, mirëmbajtjes preventive, servisimit të rregullt si dhe të monitoroj dhe siguroj që realizohen servisimet nga ofruesit e shërbimit të jashtëm për pajisjet nën garancion apo nën kontratë valide të mirëmbajtjes.
- Të përkujdeset në hartimin e kërkesave të listuara dhe teknikisht të specifikuara në suaza javore, mujore apo vjetore për furnizim të komponenteve dhe pllakave elektronike të nevojshme për procesin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore.
- Të ndihmoj personelin e sektorit në zgjerimin e diapazonit të njohurive dhe funksionalitetit praktik të komponentëve elektronike, pllakave elektronike dhe sistemit softverik të pajisjeve, njëkohësisht të angazhohet në evitimin e defekteve të tyre.
- Të asistoj dhe ndihmoj në formulimin e specifikacioneve teknike për furnizim me pajisje mjekësore të reja, pjesë rezervë, instrumente kirurgjike, inventar medicinal si dhe material shpenzues tjetër medicinal.
- Të asistoj në rregullimin e pajisjeve mjekësore të sofistikuara të cilat kërkojnë trajnim special, sidomos të përkujdeset në eliminimin e defekteve të natyrës elektronike dhe softverike.
- Të përkujdeset në kompletimin dhe ruajtjen e dokumentacionit teknik të pajisjeve mjekësore në shfrytëzim, kryesisht nga aspekti i përdorimit, mirëmbajtjes dhe servisimit elektronik dhe softverik.
- Të siguroj që produktet e reja plotësojnë nevojat e praktikës mjekësore të së nesërme.
- Të angazhohet edhe në cilësinë e inxhinierit klinik për t'u dalur në ndihmë personelit shëndetësorë rreth përcaktimit të nevojave aktuale dhe prioriteteve për furnizim me pajisje mjekësore të reja konform organizimit dhe aplikimit të metodave shëruese të avansuara.
- Të përcaktoj nevojat e trajnimit vetanak, personelit tjetër të mirëmbajtjes dhe njëkohësisht të ndihmoj në arritjen e këtyre objektivave.
- Të kryej edhe detyra tjera sipas kërkesës që dalin nga fushëveprimtaria e përgjegjësisve dhe detyrave të vendit të punës.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë universitare – Bachelor - në drejtimet bioinxhinieri, elektronikë, automatikë ose elektronikë me automatikë (e preferueshme niveli mastër ose sistemi i vjetër pesë vjeçar);
- njohuri dhe përvojë substanciale në identifikimin dhe përshkrimin e funksionalitetit të pajisjeve mjekësore apo pajisjeve të sofistikuara;
- shkathtësi të lartë në përcaktim të objektivave, komunikim, planifikim dhe bashkëpunim;
- aftësi në përshkrimin e funksionalitetit të pjesëve vitale të pajisjeve mjekësore apo atyre të sofistikuara me theks të veçantë të pllakave elektronike dhe komponentëve softverike;
- qasje fleksibile ndaj zgjidhjes së problemeve hardverike dhe softverike në pajisjet mjekësore si dhe njohja e programeve aplikative të tyre;
- shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet);
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
 - Letërnjoftimin fotokopje.
- njohja e së paku një gjuhe ndërkombëtare e domosdoshme, preferohet gjuha angleze apo gjermane;

- e dëshirueshme të ketë njohuri në menaxhimin e kontratave me platformën e-prokurimi,

6. Titulli i punës:	Teknik Profesional i Pajisjeve Biomjekësore në Sektorin e Pajisjeve Biomjekësore në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Qëllimi kryesor i vendit të punës - Teknik i Pajisjeve Mjekësore

Të mirëmbajë dhe servisoj pajisjet mjekësore nën domenin e përkujdesjes së tij, të sanoj defektet në po të njëjtat, të realizoj aktivitetet punuese në mirëmbajtjen preventive si dhe të përkrahë teknikët profesional përgjatë procesit të mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve mjekësore.

Përgjegjësitë kryesore

1. Të aplikoj masat mbrojtëse në punë, ruajtjes së ambientit, respektimit të kriterëve të kërkuara për qasje në hapësira të caktuara gjatë intervenimit në mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore.
2. Të përkujdeset që sa më parë të sanohen problemet rreth mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve mjekësore, eliminimit të defekteve të çastit, mirëmbajtjes preventive dhe të sugjeroj operuesit me pajisje për përdorim të drejtë të po të njëjtave.
3. Të plotësoj rregullisht raportet e punës për intervenime në pajisje të caktuara si dhe të informoj me kohë përgjegjësën e MPM për rezultatin apo nevojat për pjesë rezervë duke ua bashkangjitur specifikat teknike minimale të domosdoshme.
4. Të bashkëpunoj dhe koordinoj aktivitetet rreth mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore me personelin mjekësore.
5. Të përkujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veglave të punës, instrumenteve matëse dhe testuese, inventarit si dhe pasurisë.
6. Të përkujdeset dhe të asistoj në veprimtaritë e ndryshme të cilat shpiejnë në ngritjen dhe zgjerimin e diapazonit të njohurive dhe aftësive rreth mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore.
7. Të kryej edhe detyra tjera sipas kërkesës që dalin nga fushëveprimtaria e përgjegjësive dhe detyrave të vendit të punës.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar

- diplomë e sh.mesme-drejtimi teknik;
- certifikat profesionale;
- njohuri dhe përvojë substanciale në identifikimin dhe përshkrimin e pajisjeve mjekësore;
- shkathtësi në eliminimin e defekteve të shfaqura duke racionalizuar kohën dhe mjetet;
- aftësi për bashkëpunim dhe koordinim në zgjidhjen e problemeve nga aspekti i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore;
- shkathtësi në identifikimin dhe përshkrimin e pjesëve të pajisjeve mjekësore;
- njohja e punës me kompjuter dhe gjuha angleze e dëshirueshme;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- dëshmi mbi përvojën e punës në mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve mjekësore.

7. Titulli i punës:	Zyrtar të IT-së në Njësinë e IT-së në QKUK
---------------------	--

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për planifikimin e pajisjeve të teknologjisë informative të QKUK-së;
- Kujdeset për montimin e pajisjeve të teknologjisë informative përfshirë kompjuter, printer, skaner dhe pajisje tjera;
- Ndhmon personelin e institucionit në përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informative, aplikacioneve dhe bazave të të dhënave dhe kryen aktivitete tjera me qëllim për t'i ofruar gjithë personelit qasje të lehtë në sistemin e teknologjisë informative;
- Instalon kompjuterët me sisteme operative Windows, Office dhe softuer tjetër sipas nevojës duke u kujdesur për ruajtjen e shënimeve;
- Evidenton defektet në pajisje e sipas nevojës dhe në konsultim me mbikëqyrësin i mirëmban rregullisht ato;
- Ndhmon Shefin e Sektorit të Shërbimeve Teknike në kryerjen e punëve tjera në kuadër të këtij sektori,
- Bashkëpunon ngushtë me shefin e Sektorit të Shërbimeve Teknike në realizimin e punëve të përditshme në kuadër të këtij sektori,
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga Mbikëqyrësi në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diplomë e arsimit baçellor-drejtimi i shkencave kompjuterike;
- Certifikim dhe dëshmi të tjera për specializim në IT-teknologji informative dhe trajnime të ngjashme;
- Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale;
- Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
- Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Njohja e gjuhëve zyrtare në përdorim (shqip, anglisht dhe serbo-kroatisht)
- Letërnjoftimi - fotokopje.

8. Titulli i punës:	Inxhinier i Elektroteknikës në Sektorin e Shërbimeve Teknike në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe Shefit të Sektorit,
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i punës: Inxhinier i elektroteknikës - drejtimi i elektronikës,

Qëllimi i postit:

Planifikojë, koordinoj dhe të përcjell zhvillimin e aktiviteteve (punimeve) në fushëveprimin e lëmisë së elektroteknikës – drejtimi i elektronikës- automatikës, të

cilat implementohen nga palët e treta (Operatorët Ekonomik) e në raste të veçanta edhe ato të cilat kryhen nga stafi i mirëmbajtjes së brendshme të njësisë punuese përkatëse në kuadër të shërbimeve teknike . Të propozojë alternativa për zgjidhjen e problemeve të cilat paraqiten gjatë zhvillimit të proceseve në fushën e energjetikës. Të jep përkrahje teknike profesionale Shefit të Sektorit të shërbimeve teknike.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Ka për obligim që në mënyrë korrekte të bashkëpunojë me të gjithë stafin e Shërbimet Teknike dhe të shpreh gatishmëri për pune ekipore.
- Te ofroj ndihmë profesionale, me praninë e vetë, në zgjidhjen e defekteve që paraqiten në trafostacione, gjenerator, pajisje elektrike, rrjetin elektrik, pjesën komanduese të klimatizimit me ventiliim, sistemit solar dhe defekteve tjera në sistemet energjetike.
- Përgatit paramasa me paralogarit për punët pajisjet dhe materialet kur është e nevojshme të bëhet kërkesa për furnizim, në kuadër të fushëveprimit të energjetikës, duke përfshirë edhe specifikat teknike të tyre.
- Propozon masa dhe merr veprime për ngritjen e nivelit teknik të procesit të punës duke aplikuar standarde teknike të avancuara në lëmin e energjetikës.
- Përcjell zhvillimin e punimeve që kryhen në lëmin e fushëveprimit, jep vërejtje dhe sugjerime si dhe përgatit dhe dorëzon raporte të Shefi i Zyrës e sipas nevojës edhe të Shefi i Sektorit të shërbimeve teknike.
- Ka për obligim që të përgatit të dhënat teknike , të formuloj detyra projektuese dhe të jep vërejtje me kohë lidhur me të gjitha fazat e zbatimit të projekteve (që nga fillimi gjer në përfundim) për lëmin përkatës.
- Merr pjesë në vlerësime të tenderëve, komisione për pranimë teknike dhe komisione tjera sipas nevojës.
- Detyrat të cilat i epen duhet kryer në afat dhe me përpikëri.
- Të mbikëqyrë hartimin e projekteve gjatë projektimit nga ana e O.E. të licencuar dhe ekzekutimin e tyre në fushë veprimi profesional
- Bënë futjen e të dhënave të projekteve në sistemin e PIP-it (Programi për Investime Publike) për çdo vit për vitin vijues, aprovuara nga menaxhmenti i lartë.
- Përpilon (harton) raporte tre, gjashtë, nëntë dhe dymbëdhjetë mujore.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së Shefit të Sektorit Teknik që janë në lëmin e fushë veprimi të Sektorit Teknik dhe më gjer.
- Për punën e vetë i raporton dhe i përgjigjet Shefit të Zyrës dhe Shefit të Sektorit të shërbimeve teknike.

Njohuria, shkathhtësitë dhe përvoja e kërkuar

- Kualifikim Universitar- Fakulteti Elektroteknik
- Aftësi të dëshmuara profesionale për arritje të rezultateve në punë
- Shkathhtësi të mira për hartimin e raporteve, të komunikimit me gojë dhe me shkrim .
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune
- Aftësi për të udhëhequr një ekip ose grup punues;
- Aftësi për të kuptuar shpejt informacionin e ndërlikuar .
- Të jetë i gatshëm të marrë përgjegjësi për punët profesionale
- Aftësi për kryerjen e punëve grupore duke punuar në një ambient me presion.
- Njohuri të punës me kompjuter e domosdoshme.
- Njohja e gjuhës Angleze e dëshirueshme.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),

- Letërnjoftimi, fotokopje.

9. Titulli i punës:	Inxhinier i Ndërtimtarisë në Sektorin e Shërb.Tekn. në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe Shefit të Sektorit
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i vendit të punës: Inxhinier i ndërtimtarisë, një ekzekutues

Qëllimi i vendit të punës:

Planifikojë, koordinoj dhe të përcjell zhvillimin e aktiviteteve (punimeve) në fushëveprimin e lëmisë së ndërtimtarisë të cilat implementohen nga palët e treta (Operatorët Ekonomik) e në raste të veçanta edhe ato të cilat kryhen nga stafi i mirëmbajtjes së brendshme të njësisë punuese përkatëse në kuadër të shërbimeve teknike. Të propozojë alternativa për zgjidhjen e problemeve të cilat paraqiten gjatë zhvillimit të proceseve në fushën e ndërtimtarisë - hidroizolimeve. Të jep përkrahje teknike profesionale Shefit të Sektorit të shërbimeve teknike.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Ka për obligim që në mënyre korrekte të bashkëpunojë me të gjithë stafin e Shërbimet Teknike dhe të shpreh gatishmëri për punë ekipore.
- Te ofroj ndihmë profesionale, me praninë e vet në zgjidhjen e defekteve që paraqiten në lëmin e ndërtimtarisë në përgjithësi duke filluar nga hidroizolimet, hidroinstalimet kanalizimet e gjer tek defektet konstruktive.
- Përgatit paramana dhe parallogarit për punë dhe material, kur është e nevojshme të bëhet kërkesa për furnizim në kuadër të fushëveprimit të ndërtimtarisë, duke përfshirë specifikat teknike të tyre.
- Propozon masa dhe merr veprime për ngritjen e nivelit teknik të procesit të punës duke aplikuar standarde teknike të avancuara.
- Përcjell zhvillimin e punimeve që kryhen në lëmin e fushëveprimit, jep vërejtje dhe sugjerime si dhe përgatit dhe dorëzon raporte të Shefi i Zyrës e sipas nevojës edhe të Shefi i Sektorit të Shërbimeve Teknike.
- Ka për obligim që të përgatit të dhënat teknike, të formuloj detyra projektuese dhe të jep vërejtje me kohë lidhur me të gjitha fazat e zbatimit të projekteve (që nga fillimi gjer në përfundim) për lëmin përkatëse.
- Merr pjesë në vlerësime të tenderëve, komisione për pranimë teknike dhe komisione tjera sipas nevojës.
- Detyrat të cilat i open duhet kryer në afat dhe me përpikmeri.
- Përpilon (harton) raporte tre, gjashtë, nëntë dhe dymbëdhjetë mujore.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së Shefit të Sektorit Teknike që janë në lëmin e fusheveprimit të Sektorit Teknik dhe më gjerë.
- Për punën e vetë i raporton dhe i përgjigjet Shefit të Zyrës dhe Shefit të Sektorit të shërbimeve teknike.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar:

- Kualifikim Universitar- Fakulteti Teknik i Ndërtimtarisë

- Aftësi të dëshmuara profesionale për arritje të rezultateve në punë
- Shkathtësi të mira hulumtuese për hartimin e raporteve , të komunikimit me gojë dhe me shkrim.
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune
- Aftësi për të udhëhequr një ekip ose grup punues;
- Aftësi për të kuptuar shpejt informacionin e ndërlikuar .
- Të jetë i gatshëm të marre përgjegjësi për punët profesionale
- Aftësi për kryerjen e punëve grupore duke punuar në një ambient me presion.
- Njohuri të punës me kompjuter e domosdoshme.
- Njohja e gjuhës Angleze e dëshirueshme.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Letërnjoftimi, fotokopje.

10. Titulli i punës:	Inxhinier për Arkitekturë në Sektorin e Shërbimeve
	Teknike në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe Shefit të Sektorit
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i vendit të punës: Inxhinier për arkitekturë - një ekzekutues

Qëllimi i vendit të punës:

Planifikojë, koordinoj dhe të përcjell zhvillimin e aktiviteteve (punimeve) në fushëveprimin e lëmisë së arkitekturës së objekteve dhe infrastrukturës jashtme të cilat implementohen nga palët e treta (Operatorët Ekonomik) e në raste të veçanta edhe ato të cilat kryhen nga stafi i mirëmbajtjes së brendshme të njësisë punuese përkatëse në kuadër të shërbimeve teknike. Të propozojë alternativa për zgjidhjen e problemeve dhe paqartësive të cilat paraqiten gjatë zhvillimit të proceseve në fushën e arkitekturës. Të jep përkrahje teknike profesionale Shefit të Sektorit të shërbimeve teknike.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Ka për obligim që në mënyre korrekte të bashkëpunojë me të gjithë stafin e Shërbimet Teknike dhe të shpreh gatishmëri për pune ekipore.
- Të ofroj ndihmë profesionale, me praninë e vet, në zgjidhjen e defekteve që paraqiten në lëmin e arkitekturës së objekteve si brenda ashtu jashtë tyre si dhe infrastrukturën e jashtme.
- Përgatit paramasa me parallogarit për punë dhe material, kur është e nevojshme të bëhet kërkesa për furnizim në kuadër të fushëveprimit të arkitekturës, duke përfshirë specifikat teknike të tyre.
- Propozon masa dhe merr veprime për ngritjen e nivelit teknik të procesit të punës duke aplikuar standarde teknike të avancuara të arkitekturës.
- Përcjell zhvillimin e punimeve që kryhen në lëmin e fushëveprimit, jep vërejtje dhe sugjerime si dhe përgatit dhe dorëzon raporte të Shefi i Zyrës e sipas nevojës edhe të Shefi i Sektorit të Shërbimeve Teknike.

- Ka për obligim që të përgatit të dhënat teknike, të formuloj detyra projektuese dhe të jep vërejtje me kohë lidhur me të gjitha fazat e zbatimit të projekteve (që nga fillimi gjer në përfundim) për lëmin përkatëse dhe më gjerë.
- Merr pjesë në vlerësime të tenderëve, komisione për pranime teknike dhe komisione tjera sipas nevojës.
- Detyrat të cilat i epen duhet kryer në afat dhe me përpikmeri.
- Përpilon (harton) raporte tre, gjashtë, nëntë dhe dymbëdhjetë mujore.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së Shefit të Sektorit Teknik që janë në lëmin e fushe veprimit të Sektorit Teknik dhe më gjerë.
- Për punën e vetë i raporton dhe i përgjigjet Shefit të Zyrës dhe Shefit të Sektorit të Shërbimeve Teknike.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar:

- **Kualifikim Universitar- Fakulteti Teknik i Arkitekturës**
- Aftësi të dëshmuara profesionale për arritje të rezultateve në punë.
- Shkathtësi të mira hulumtuese për hartimin e raporteve, të komunikimit me gojë dhe me shkrim.
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune.
- Aftësi për të udhëhequr një ekip ose grup punues.
- Aftësi për të kuptuar shpejt informacionin e ndërlikuar.
- Të jetë i gatshëm të marrë përgjegjësi për punët profesionale
- Aftësi për kryerjen e punëve grupore duke punuar në një ambient me presion.
- Njohuri të punës me kompjuter e domosdoshme.
- Njohja e gjuhës Angleze e dëshirueshme.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Letërnjoftimi, fotokopje.

11. Titulli i punës:	Elektriciist në Sektorin e Shërb.Teknike në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i vendit të punës: Teknik i Energjetikës - Elektriciistë,

Qëllimi i vendit të punës

Bën mirëmbajtjen elektrike të të gjitha instalimeve dhe pajisjeve elektrike në kuadër të shërbimit elektroenergjetik dhe atij termoenergjetik

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Bën mirëmbajtjen e instalimeve elektrike për ndriçim të brendshëm, të jashtëm, instalimeve kundër rrufesë, etj.,

- Bën mirëmbajtjen elektrike të rregullt të pajisjeve të Kuzhinës, Lavatores, klimatizimit me ventilim, sistemit solar, kaldatorës, nënstacioneve të ngrohjes dhe ujit të ngrohtë sanitar.
- Kryen punët e riparimit dhe evitimin e prishjeve në instalimet, aparatet dhe pajisjet tjera elektrike, në rast nevojë kryen edhe instalime të qarqeve elektrike.
- Bën kontrollimin e rregullt mbi gjendjen funksionale të elektromotorëve, dhe pajisjeve tjera elektrike.
- Bën mirëmbajtjen rutinore elektrike të të gjitha pajisjeve dhe instalimeve tjera elektrike në të gjitha objektet e QKUK.
- Është i obliguar që t'i përgjigjet të gjitha ftesave emergjente për evitimin e prishjeve të instalimeve dhe të pajisjeve, elektrike
- Është përgjegjës që ti përmbahet procedurave dhe rregullave të sigurisë në punë duke përfshirë edhe mbajtjen e pajisjeve personale mbrojtëse,
- Është përgjegjës për rregullsinë e pajisjeve dhe instalimeve elektrike,
- Është përgjegjës për kryerjen kualitative të punëve dhe për mjetet e punës.
- Kryen dhe punë të tjera që ia cakton Udhëheqësi i njësisë punuese
- Për punën e vet i raporton Udhëheqësit të njësisë punuese - Udhëheqësit të Nj.O.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar

- Diploma e Shkollës së mesme teknike dega - elektroteknikës - energjetike – certifikatë,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Dëshmi mbi përvojën e punës në lëmin e elektroenergjetikës
- Njohja e punës për operim me pajisje elektrike.
- Letërnjoftimi, fotokopje.

12. Titulli i punës:	Operues në Sektorin e Shërb.Teknike në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i vendit të punës: Operues (manipulues) me pajisje dhe sistem të gazrave Medicinale (bocament):

Qëllimi i vendit të punës

Operimi dhe mirëmbajtja e pajisjes së gazit medicinal.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Është i obliguar që gjatë orarit të punës t'u përmbahet masave të mbrojtjes në punë, standardeve teknike për pajisjen që e ka në përdorim dhe udhëzimeve për punë për pajisjet të kësaj natyre.
- Është i obliguar që gjatë orarit të punës të bashkëpunojë me personelin e klinikës dhe të plotësojë kërkesat e personelit të autorizuar mjekësor që kanë të bëjnë me përdorimin – konsumin e gazit medicinal për nevojat e pacientëve.
- Kontrollon pajisjen, gjendjen funksionale dhe paralajmëron me kohë udhëheqësin e drejtpërdrejtë për furnizim me sasinë e mjaftueshme të gazit medicinal si në përdorim e gjithashtu në rezervë të nevojshme.

- Është përgjegjës për pajisjen që e ka në deponim që ta kontrolloi, dhe t'a mirepërdorë ashtu që pajisja të jete në gjendje funksionale dhe në gjendje gatishmërie për përdorim kurdo që është e nevojshme.
- Me kujdes të lartë bën bartjen e bombolave të gazit, vendin e vendosjes, mbylljen me kapak dhe ruajtjen e tyre si dhe ruajtjen nga qasja e personave të pa autorizuar.
- Është i obliguar që t'u përmbahet udhëzimeve për punë që ipen nga udhëheqësi drejtpërdrejtë.
- Për çdo defekt apo parregullsi të pajisjes që e vëren gjatë orarit të punës, duhet të ndërmerri masat në kuadër të njohurive dhe mënjëherë e lajmëron udhëheqësin e drejtpërdrejtë për masat e mëtejme.
- Është i obliguar që konsumi i gazit medicinal të jetë sa më racional dhe humbjet e panevojshme të çfarëdo natyre qofshin, të zvogëlohen në minimum.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të Shërbimit.
- Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të drejtpërdrejtë te njësisë punues më pastaj edhe Shefit të Sektorit të shërbimeve teknike.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë e Shkollës së Mesme (drejtimi jo mjekësor)
- I certifikuar për operim me pajisje dhe sistem të gazrave medicinale,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Certifikata mbi aftësimin e operimit me pajisje dhe sistem të gazrave medicinale.
- Aftësi për evitimin e defekteve të çastit,
- Letërnjoftimi, fotokopje.

13. Titulli i punës:	Ujëinstalues në Sektorin e Shërb.Teknike në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i punës: Ujëinstaluesi

Qëllimi i vendit të punës:

- Mirëmbajtja e instalimeve të ujit, kanalizimit, elementeve të sanitarisë, zdrukthtarisë si dhe lyerjen e sipërfaqeve në klinikat dhe objektet e QKUK-se.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Ben mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit në të gjitha objektet dhe hapësirat e QKUK-se.
- Ben mirëmbajtjen e instalimeve të ujit në të gjitha objektet e QKUK-së.
- Ben mirëmbajtjen e elementeve sanitare në të gjitha njejet sanitare të objekteve dhe në rast nevojë bënë ndërrimin e tyre.
- Punon në evitimin e defekteve, sanimin e tyre dhe riparimin e instalimeve të ujit.
- Punon në montimin e elementeve sanitare, mekanizmave të dyerve dritareve, knaufit, dhe elementeve tjera ndërtimore.
- Bënë deblokimin e gypave të kanalizimeve si dhe pastrimin e gypave të ujit nëse paraqitet nevojja.
- Bënë instalime të reja të ujit të ftohtë dhe të ngrohtë sanitar, ndarjen e hapësirave qoftë përmes knaufit apo miratimit me elemente përkatëse si dhe lyerjen e tyre.
- Ben modifikimin e ndjeve sanitare.

- Ben mirëmbajtjen elementeve të zdrukthëtarisë në objektet dhe në rast nevojë bën ndërrimin e tyre.
- Bën evitimin e defekteve, sanimin e tyre si dhe riparimin e elementeve të zdrukthëtarisë.
- Ben punët përgatitore për ngjyrosje.
- Kryen punët e ngjyrosjes me ngjyra në sipërfaqet e mureve dhe pllafoneve.
- Kryen punët e ngjyrosjes me ngjyra dhe llaqe të dyerve, dritareve prej druri, dhe metali, orendive të ndryshme dhe elementeve tjera.
- Bën sanimin e dëmtimeve të mureve dhe sipërfaqeve tjera si dhe lyerjen e tyre me ngjyra dhe llaqe përkatëse.
- Mban evidencën në urdhëresave të punës për punën e kryer dhe materialin e shpenzuar.
- Kryen të gjitha punët që i cakton përgjegjësi- Udhëheqësi
- Për punën e vet i referohet udhëheqësit.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar:

- Shkolla e mesme profesionale,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Shkathtësi në punë
- Njohës i teknikes së ujit, kanalizimit, zdrukthëtarisë dhe lyerjes me ngjyra dhe llaqe.
- Njohës i veglave të punës.
- Të punoi në grupe punuese.
- Letërnjoftimi, fotokopje.

14. Titulli i punës:	Depoist / Gardarobier në Sektorin e Shërb.Teknike në QKUK
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja:	Kontrata me afat të pa caktuar

Titulli i punës: Depoist - Gardarobier:

Qëllimi i vendit të punës:

- Furnizimi i personelit të klinikave me petka të pastëra.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Bën furnizimin e klinikave me petka të pastëra.
- Ngarkohet me petka dhe pixhama të pacientëve.
- Ruan dhe kujdeset për rrobat e pacientëve të shtruar në klinike.
- Kryen punë sipas urdheresës së udhëheqësit të klinikës.
- Kujdeset për higjienën e mjedisit të punës.
- Mban evidencën e petkave që ka në lavatore, në garderobe dhe në reparte.
- Sipas nevojës kryen edhe punë të tjera sipas urdheresës së udhëheqësit.
- Për punën e vetë përgjigjet udhëheqësit njësisë punuese (Nj.P)
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës të Udhëheqësit të Lavatorës.
- Për punën e vetë i përgjigjet Udhëheqësit të Lavatorës.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë e Shkollës së Mesme (drejtimi jo mjekësor),

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Vërtetimin nga Gjykata Kompetente),
- Aftësi punuese dhe gatishmëri të punoi në ndërrime.
- Aftësi fizike për punë.
- Letërnjoftimi, fotokopje.

15. Titulli i punës: **Punëtor/re në Lavatore** në Sektorin e Shërb.Teknike në QKUK
 Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
 Nëpunësi mbikëqyrës: Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë
 Kohëzgjatja: Kontrata me afat të pa caktuar

